



RE PUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA
DREJTORIA E MENAXHIMIT, PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT

Lënda: Analizë e realizimit të detyrave për vitin 2019

KËTU

Në zbatim të Programit të punës për vitin 2019, Programit Strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020, Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura, si dhe Planit të detajuar të punës për zonat e mbrojtura, të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në lidhje me punën e kryer nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2019, ju informojmë se:

Sektori i Menaxhimit

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2019 u përball me sfida dhe probleme të shumta, një pjesë e së cilave ishin të mbartura nga viti 2018 siç ishin;

- Kontratat e punimeve lidhur me ish-DRSHP-të, llojet e veprimtarive, baza ligjore e lejueshmërisë, likuidimi financiar i tyre.

1. Një ndër detyrat kryesore për sektorin e menaxhimit ka qënë lidhja e kontratave të reja dhe vazhdimi me kontratat e mëparshme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve zonë e mbrojtur, në zbatim të Ligjit nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, , të VKM-së nr. 382, datë 25.05.2016 “Për disa shtesa në VKM-ne nr. 102, datë 04.02.2015” VKM nr. 102, datë 04.02. 2015 “Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit e të organizimit të AKZM-së dhe të AdZM-ve në qarqe”.

Sektori i menaxhimit në bashkëpunim me AdZM-të në qarqe në zbatim të ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, mbështetur në VKM-të përkatëse të shpalljes së zonës së mbrojtur, zonimit të brendshëm të tyre, planit të menaxhimit (kur është miratuar) dhe të urdhërit nr. 129, datë datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura” kanë shqyrtuar dhe vlerësuar kërkesat e ardhura për të lidhur kontrata për veprimtaritë që lejohen të zhvillohen në zonat e mbrojtura si dhe ka kërkuar të anulohen ato kontrata që janë lidhur nga ish-DRSHP-të në kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Ndër veprimtaritë e lejuara në territorin e zonave të mbrojtura është dhe ushtrimi i aktivitetit të kullotjes së blegtorisë nëpërmjet lidhjes së kontratave me qira të sipërfaqeve kullimore. Në zbatim të ligjit nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” të ndryshuar, Udhëzimit nr.4, datë 10.04.2008 “Mbi caktimin e kriterëve teknike dhe procedurave të dhënies për kullotje dhe kositje bari” dhe Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të miratimit të parcelave kullimore të zonës së mbrojtur.

Kështu gjatë vitit 2019, kjo veprimtari u zhvillua në disa sipërfaqe kullimore të zonave të mbrojtura që gjenden në PK, RNM e PM dhe konkretisht:

AdZM-ja Berat ka lidhur gjithsej 16 kontrata, me sipërfaqe totale prej 931.5 ha.

AdZM-ja Dibër ka lidhur gjithsej 12 kontrata me sipërfaqe totale 305.1.

AdZM-ja Elbasan ka lidhur gjithsej 17 me sipërfaqe prej 265.0 ha.

AdZM-ja Gjirokastrë ka lidhur gjithsej 68 kontratat me sipërfaqe totale prej 8321.0 ha.

AdZM-ja Korçë ka lidhur gjithsej 25 kontrata me sipërfaqe totale 2520.0 ha.

AdZM-ja Tiranë ka lidhur gjithsej 31 kontrata me sipërfaqe totale 334.66 ha.

AdZM-ja Vlorë ka lidhur gjithsej 49 kontrata me sipërfaqe totale 1731.65 ha


AdZM-ja Lezhë ka lidhur gjithsej 1 kontratë me sipërfaqe totale 705 ha.

Evidenca përmblendhëse mbi aktivitetin e kullotjes, sipas viteve 2017, 2018, 2019


N/R	AdZM-ja	Nr. kontratave			Sip. (ha)		
		2017	2018	2019	2017	2018	2019
1	Berat	27	20	16	1421.0	1292.2	931.5
2	Dibër	3	7	12	92.0	162.1	305.1
3	Elbasan	23	20	17	502.0	462.2	265.0
4	Gjirokastrë	35	37	68	3058.0	4161	8321.0
5	Korçë	18	24	25	2364.0	2414	2520.0
6	Tiranë	29	31	25	3986.0	940.7	334.66
7	Vlorë	56	57	49	2197.0	1675.5	1731.65
8	Kukës	-	2	2	-	5.5	1.5
9	Shkodër	-	2	-	-	19.0	-
10	Lezhë	-	1	-	-	705.0	366.0
	TOTALI	191	201	214	8485.0	11498.3	14410.4

Duke bërë krahasimin midis tre viteve, vërejmë se numri i kontratave që janë lidhur është rritur nga ndër vite nga 191 kontrata në vitin 2017 në 201 në vitin 2018 dhe me 214 kontrat në vitin 2019, po kështu dhe sipërfaqja kullimore e kontraktuar është rritur nga 8485 ha në 14410.4 ha. Këto tregues shprehin rritjen nga viti në vit të sipërfaqeve kullimore që po kontraktohen. Sipas treguesve kadastrale dhe zonave ku lejohet të ushtrohet veprimtaria e kullotjes në territorin e zonave të mbrojtura, gjykojmë se si numri i kontratave dhe sipërfaqja kullimore ku lejohet të ushtrohet kjo veprimtari duhet të rritet, kjo e konfirmuar dhe nga vetë AdZM-të. Sipas tabelës dhe grafikut konstatohet rritje e numrit kontratave dhe të sipërfaqes së kontrktuar nga AdZM-ja Gjirokastrë. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e shpalljes së zonës së mbrojtur të PN “Zagori”, brenda të cilit gjenden shumë sipërfaqe kullimore të shfrytëzueshme si dhe bashkëpunimi i AdZM Gjirokastrë me strukturat vendore të bashkisë Libohovë. Po kështu vërejmë se në disa AdZM si Berati, Elbasani, Tirana dhe Vlora kanë lidhur më pak kontrata dhe kanë zvogëlim të sipërfaqes kullimore të kontraktuar, ndaj këto AdZM duhet të analizojnë faktorët që kanë ndikuar dhe të marrin masa për të përmirësuar gjendjen.

Treguësit krahasues midis 3 (tre) viteve cituar më lart i japim dhe grafiksht, si për numrin e kontratave (grafiku nr. 1) ashtu dhe për sipërfaqet e kullotave të kontraktuara (gafiku nr.2).



Në grafikun më poshtë jepen sipërfaqet kullimore zonë e mbrojtur, ku janë lidhur kontrata qiraje sipas AdZM-ve



- ❖ Burim tjetër ku mund të realizohen të ardhura në territoret e zonave të mbrojtura është dhe **Dhënia në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve pyjore/kullosore, zonë e mbrojtur** subjekteve apo personave fizik për zhvillimin e veprimtarive të lejuara. Kështu në zbatim ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura”, gjatë vitit 2019 pranë AdZM-ve nga subjekte të ndryshëm janë paraqitur kërkesa të shumta me natyra të ndryshme për zhvillim veprimtarish të lejuara brenda territorit të zonave të mbrojtura dhe konkretisht:

Në AdZM-në e Lezhës për vitin 2019 janë dërguar 3 (tre) kërkesa nga subjekte apo persona fizik për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave (dokumentacionit shoqërues), nga kjo administratë, kërkesat janë dërguar për miratim në AKZM dhe me miratimin e tyre AdZM-ja lezhë ka lidhur kontrata qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht:

Në RNM “Kune – Vain – Tale” në ekonominë pyjore Shëngjin – Tale, në zonë Rekreative (ZR), janë shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 3 (tre) kërkesa me objekt për zhvillimin e veprimtarisë së lejuar “Vendosje njësi portative provizore prej druri me strukturë prej druri e zmontueshme pa themel”.

Në AdZM-në e Tiranës janë dërguar 5 (pesë) kërkesa nga subjekte apo persona fizik për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave (dokumentacionit shoqërues) të kësaj administrate, kërkesat janë dërguar pranë AKZM-së për miratimin e kontratës dhe më pas AdZM-ja Tiranë ka lidhur kontrata qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht:

Në PK “Mali i Dajtit” në ekonominë pyjore “Zallherr - Priskë”, në zonën e Bovillës, është shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (një) kërkesë për rikonstruktivimin e një strukture të linjës së tubacionit të ujësjellësit ekzistues duke e devijuar atë dhe më pas për ta shfrytëzuar për prodhim energjie (me miratim të MIE dhe Ujesjellës – Kanalizimit të Tiranës”, për subjektin “Tirana Energji” sh.p.k. AdZM Tiranë ende nuk ka lidhur kontratën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje.

Në PK “Mali i Dajtit” në ekonominë pyjore “Dajt”, në zonën e Rekracionit 1 (ZR1), janë shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 2 (dy) kërkesa për zhvillimin e veprimtarive të lejuara “Vendosje njësi portative provizore prej druri me strukturë prej druri e zmontueshme pa themel, kënde lojrash dhe fusha sportive”, të nevojshme dhe domosdoshme për argëtimin, pushimin dhe çlodhjen e vizitorëve dhe turistëve.

Në PK “Mali i Dajtit” në ekonominë pyjore “Dajt”, në zonën e Rekracionit 2 (ZR2), janë shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 2 (dy) kërkesa për zhvillimin e veprimtarive të lejuara “Vendosje njësi portative me strukturë prej druri e zmontueshme pa themel, njësi shërbimesh për pushim e çlodhje qëllimie shëndetësore, vrojtim në natyrë për pushuesit dhe vizitorët.

AdZM-ja Fier ka pranuar dhe shqyrtuar 2 (dy) kërkesa nga një subjektë të ndryshëm për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Divjakë - Karavasta” në ekonomisë pyjore “Gjinarukë- Godull”, për zhvillimin e veprimtarisë “Vendosje njësi portative me strukturë prej druri, të zmontueshme dhe pa themel”, për qëllime vrojtme në natyrë, të zogjsh dhe shpendësh, ecje në natyrë, qendër rekreacioni dhe njësi gastronomike në zonën përreth.

Në AdZM-në e Korçës janë dërguar nga subjekte apo persona fizik 13 (trembëdhjetë) kërkesa për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave (dokumentacionit shoqërues), me miratim nga AKZM ka lidhur kontrata qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht:

Në PK “Prespë” në ekonominë pyjore “Gorica 1”, dhe në ekonominë pyjore “Qafzvezdë-Tresenik” në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm (ZZHQ), është shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (një) kërkesë për zhvillimin e veprimtarive të lejuara “Ndërtimin dhe funksionimin e Antenës në ZK 1809, Goricë”, dhe “Ndërtim dhe funksionimin e antenës ekzistuese”.

Në PMU/T “Pogradec” në ekonominë pyjore “Guri i kuq – Lin”, në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm (ZZHQ), është shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (një) kërkesë për zhvillimin e veprimtarisë së lejuar “Vendosjen e platformës me konstruksion prej druri për pushim, çlodhje dhe vrojtimit të natyrës nga vizitorët e turistët”. Subjekti edhe pse ka lidhur kontratën e marrjes në përdorim të sipërfaqes nga verifikimi në terren rezultojë se ende nuk ka bërë asgjë. Sipërfaqja e zonës së mbrojtur është e pa cënuar përveç një kufizimi në katër pika.

Në PMU/T “Pogradec” në ekonominë pyjore “Guri i kuq – Lin”, në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm (ZZHQ), është shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 6 (gjashtë) kërkesa për zhvillimin e veprimtarisë së lejuar “Agropylltari”, për mbjellje pemësh drufrutor si lajthi, Bajame, Gështenjë, Qershijë etj. Disa nga subjektet edhe pse kanë lidhur kontratën e marrjes në përdorim të sipërfaqes ende nuk kanë kryer asnjë proces pune. Për këtë gjendje AdZM-ja Korçë duhet të njoftojë zyrtarisht subjektet duke i lënë një afat të përcaktuar kohe nëse nuk do të kryejnë punime do të njoftohen për ndërprerje të kontratës.

Në PMU/T “Pogradec” në ekonominë pyjore “Alarup”, në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm (ZZHQ), është shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 3 (tre) kërkesa për zhvillimin e veprimtarisë së lejuar “Agropylltari”, për mbjellje pemësh drufrutor si lajthi, Bajame, Gështenjë, Qershijë etj. Disa nga subjektet edhe pse kanë lidhur kontratën e marrjes në përdorim të sipërfaqes ende nuk kanë kryer asnjë proces pune. Për këtë gjendje AdZM-ja Korçë duhet të njoftojë zyrtarisht subjektet duke i lënë një afat të përcaktuar kohe nëse nuk do të kryejnë punime do të njoftohen për ndërprerje të kontratës.

Në PK “Bredhi i Hotovës – Dangëlli”, në ekonominë pyjore “Leskovik”, në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm, subjekti “M.T.C. – Energy” sh.p.k. ka ndërtuar një Hec shumë vite më parë, i cili tashmë është në prodhim energjie dhe ka patur një kontratë qiraje për dhënie në përdorim me ish-DSHP e Kolonjës. Në këto kushte pasi është rehabilituar e gjitha sipërfaqja dhe është minimizuar impakti në mjedis AdZM – Karoçë ka lidhur kontratën e qirasë për sipërfaqen zonë e mbrojtur. Pranë kësaj Administrate është lidhur dhe Aneks- kontrata me subjektin “Alb Frut 2005”, sh.p.k. p me objekt “Kultivim i bimëve pyjore, mjeksore dhe eterovajore”

Në AdZM-në e Shkodrës janë dërguar nga subjekte gjithsej 6 (gjashtë) kërkesa për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave (dokumentacionit shoqërues), me miratim nga AKZM ka lidhur kontratë qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht:

Në PMU/T “Lumi Buna - Velipojë” në ekonominë pyjore “Dajç-Velipojë”, është shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 2 (dy) kërkesa për zhvillimin e veprimtarisë së lejuar me objekt “Vendosje e njësisë portative prej druri, njësi rulotë, kampig për fëmijë etj.”.

Në PMU/T “Lumi Buna - Velipojë” në ekonominë pyjore “Velipojë - Rezervat”, është shqyrtuar e vlerësuar, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 4 (katër) kërkesa për zhvillimin e veprimtarisë së lejuar me objekt “Vendosje e njësisë portative prej druri, njësi shërbimesh për vizitorët/turistët, për çlodhje, pushim, argëtim dhe vrojtim në natyrë etj.”.

AdZM-ja Vlorë ka pranuar dhe shqyrtuar 2 (dy) kërkesë nga një subjekt për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Butrint” në ekonomisë pyjore “Stillo Vrinë”, ku ka vlerësuar se është dakort për zhvillimin e veprimtarisë “Zhytje për eksplorim të botës nënujore”, nga subjekti “Kromos – Konstruksion”.

AdZM-ja Vlorë ka vlerësuar se disa kontratave u ka përfunduar afati i dhënies në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur, ndaj ka njoftuar subjektet se këto kontrata nuk mund të vazhdojnë më.

AdZM-ja Kukës ka shqyrtuar dhe vlerësuar kërkesën e 1 (një) subjekti për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:


Në PK “Lugina e Valbonës” në ekonomisë pyjore “Valbonë - Çerem”, ku ka vlerësuar se është dakort për zhvillimin e veprimtarisë “Ndërtim Antene telefonike Valbona 1560”.


Nr	ZM	AdZM	Numri i kontratave		
			2017	2018	2019
1	RNM “Kune – Vain–Tale”	Lezhë	7	1	3
	RNM “Fushë Kuqe – Patok – Ishëm”		2	2	0
2	PK “Mali i Dajtit”	Tiranë	3	3	5
	PM “Mali me gropa – Bizë - Martanesh		0	3	0
3	PK “Divjakë - Karavasta”	Fier	1	1	2
4	PK “Prespë”	Korçë		2	1
	PMU/T “Pogradec”		2	1	11

5	RNM “Kuturman”	Elbasan	1	-	1
6	PMU/T “Lumi Buna - Velipojë”	Shkodër	2	1	6
7	PK “Butrint”	Vlorë		1	1
	PK “Syri i Kaltër”		1	0	0
8	PK “Bredhi i Hotovës – Dangëlli”	Gjirokastër	1	-	2
9	PK “Lugina e Valbonës”	Kukës		1	1
	PN “Korab - Koritnik”		1		0
	ZMBM “Luzni-Bulaç” ZPT	Dibër	0	0	1
	PK “Qafë-Shtamë”	Durrës	0	0	6
	MN “Plazhi i Shënpjetrit”		0	0	1
	Totali		21	16	42

Duke bërë krahasimin ndërmjet tre viteve, vërejmë se numri i kontratave të qirasë për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur është i ndryshëm . Kështu në vitin 2017 janë lidhur gjithsej 21 kontrata, në vitin 2018 janë më pak 16 të tilla, ndërsa në vitin 2019, është rritur numri i kontratave me 42. Po ti shikojmë lidhur me fushën e veprimtarisë së kërkuar rezulton se shumica prej tyre janë kontrata qiraje për të zhvilluar veprimtari me objekt “Vendosje njësi portative prej druri, të zmontueshme pa themel”. Krahas kësaj vërejmë se gjatë vitit 2019 vetëm AdZM-ja Korçë ka pranuar dhe vlerësuar 9 (nëntë) kërkesa në zonën e PMU/T “Pogradec”, për “Agropylltari” (mbjellje fidanash dru frutor).

Në grafikun më poshtë jepen të dhënat sipas AdZM-ve, krahasuar për tre vite.





Po kështu, sektori i menaxhimit në zbatim të Urdhërit të MM Nr. 129, datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura” dhe plotësimit të kriterëve sipas “Aneksit” të këtij urdhëri që duhen përmbushur nga AdZM-të dhe subjekti kërkues, i ka shqyrtuar e analizuar me hollësi kërkesat e paraqitura duke iu referuar vlerësimit të AdZM-ve dhe specifikave teknike që ka kërkesa e subjektit. Drejtoria e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit (Sektori i Menaxhimit), pas verifikimit edhe një herë për vendodhjen dhe dokumentacionit shoqërues, ka përgatitur MEMO-n dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm për miratimin e lidhjes së kontratës nga AdZM-ja.

- ❖ Gjatë këtij viti janë lidhur kontrata me qira për dhënie në përdorim sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor zonë e mbrojtur edhe me subjektet për ndërtim HEC-i miratuar me Urdhër të Ministrit të Mjedisit “Për heqje dhe dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur dhe konkretisht apo kanë qënë kontrata të lidhura më parë nga ish-DSHP-të:

AdZM-ja Tiranë Në PK “Mali i Dajtit” në ekonominë pyjore “Zallherr-Priskë”, është shqyrtuar e vlerësuar për dhënie në përdorim me kontratë qiraje 1 (një) kërkesë për zhvillimin e veprimtarisë ..”Hec Mali “, Tirana Energji”.

AdZM-ja Korçë ka pranuar dhe shqyrtuar 1 (një) kërkesë nga një subjekt për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Bredhi i Hotovës – Dangëlli” në ekonominë pyjore “Leskovik”, për zhvillimin e veprimtarisë të një Heci “Radova” ndërtuar shumë vite më parë dhe me kontratë nga ish SHP-ja Kolonjë nga subjekti “M.T.C. Energy” sh.p.k..

Nr	Subjekti	Veprimtaria	Zona e Mbrojtur	AdZM-ja
1	“Tirana Energji”	Ndërtim HEC-i	PK “Mali i Dajtit”	Tiranë
2	“M.T.C. Energy”	Ndërtim Hec Radova	PK“Bredhi i Hotovës – Dangëlli”	Gjirokastrë


Sektori i menaxhimit gjithashtu ka kërkuar që për rastet e kontratave që janë në vazhdim (kontrata të mbartura nga ish-DRSHP-të), ku AdZM-të rivlerësojnë gjithë dokumentacionin ekzistues në arshivat e këtyre drejtorive apo dërguar nga subjekti. Kështu në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe shërbimeve të brendshme dhe AdZM-të përkatëse po ndjekim dhe kontrollojmë pagesat vjetore, likuidimi financiar të tyre për çdo vit dhe detyrimet e pa paguara, detyrë e kërkuar dhe nga audit i KLSH-së. AdZM-të janë porositur ta ndjekin në vijimësi këtë problem. Kjo detyrë po ndiqet në zbatim të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 557, datë 30.05.2016 “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të lidhura me ish- DRSHP-të dhe vazhdim”.


- ❖ Gjatë monitorimit dhe verifikimeve nga AdZM-të janë konstatuar dhe subjekte të cilët kanë kryer veprimtari për nxjerrje të gurit gëlqeror (gurore), por ende nuk janë rehabilituar sipërfaqet e dëmtuara gjatë punimev. Për këtë problem po studiojmë me hollësi çdo kërkesë që paraqitet nga AdZM-të, në zbatim të Ligjit nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, duke analizuar, kategorinë e zonës së mbrojtur, zonimin e brendshëm të vendodhjes së karrierës, projektin teknik të zbatimit së bashku me gjurmën e shtrirjes së aseteve mbështetëse, afatin e lejes konçensionare, afatin e lejes mjedisore, VNM-në, projektin e rehabilitimit etj. Rast i tillë është ajo e ish-gurores së vjetër në PMU/T “Lumi Buna – Velipojë”.
- ❖ - Ndër detyrat kryesore të sektorit gjatë gjithë vitit 2019 ka qënë, përgatitja dhe dërgimi në afat pranë AKM-së dhe institucioneve të tjera opinionin e AKZM **“Dhënie mendimi”**, lidhur me kërkesat e bëra nga subjekte të ndryshëm për zhvillimin e veprimtareve të lejuara ose jo, brenda territoreve të zonave të mbrojtura. Kërkesat e subjekteve konsistojnë në zhvillimin e veprimtarive të ndryshme ekonomike, social kulturore, eko-turistike dhe agro-turistike, edukimin mjedisor, veprimtari për zhvillimin e Agropylltarisë, projekte gjeneruese për burimet energjitike (nga era, panelet diellore), studimore e kërkimore e eksperimentale. Ka dhe raste për subjektet që kërkojnë për herë të parë të zhvillojnë veprimtari të lejuara.
- ❖ Detyrë shumë e rëndësishme për sektorin e menaxhimit gjatë vitit 2019 ka qënë; shqyrtimi, dhe vlerësimi i kërkesave, dërguar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) në rrugë elektronike për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme në territorin e zonave të mbrojtura. **“Dhëniet e mendimit”** janë përgatitur bazuar në ligjin nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, të akteve të tjera nënligjore, VKM-së së shpalljes së zonës së mbrojtur, zonimit të brendshëm e planit të menaxhimit, bazuar në strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura, zhvillimit për një menaxhim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe së fundmi dhe të PPV-ve të bashkive.
- ❖ Gjatë vitit 2019 janë përgatitur për “Dhënie Mendimi” gjithsej 320 raste nga këto:
 - Aktiviteti minerarë (miniera kromi dhe gurore): 17,
 - Ndërtim HEC-e dhe rivënie në punë të HEC-e: 92
 - Ndërtime resortesh, bar-restorante, kapanone mobiljesh komplekse turizmi etj,: 45,
 - Ndërtim segmente rrugësh, rikonstruksion, rikualifikim e rehabilitim pika kalimi etj: 15,
 - Projekte gjeneruese me erë, panela diellore : 7,

- Vendorsje antenash, pika transmetimi, nënstacione etj : 22,
 - Fabrika riciklimi, Riciklim mbetjesh spitalore etj: 2
 - Fabrika për mobilimin e ujit, vendorsje impiantesh etj.: 9
 - Njësi shërbimesh blegtorale: 18
 - Ndërtime të lehta, vendorsje njësi portative: 56
 - Mbjellje fidanash dru frutor “Agropylltari”: 37
- Pothuaj për të gjitha rastet kane ardhur mendime 2-3 herë.

Më poshtë po japim grafikisht rastet “Për Dhënie mendimi”, shprehur në numër rastesh, sipas aktiviteteve të kërkuara nga subjektet:

Nr	Lloji i veprimtarive	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Aktiviteti minerare (miniera kromi dhe gurore)	23	50	17
2	Ndërtim HEC-e dhe rivënie në punë të HEC-e	37	62	92
3	Ndërtime resortesh, bar-restorante, kabanone mobiljesh komplekse turizmi etj	32	38	45
4	Ndërtim segmente rrugësh, rikonstruksion, rikualifikim e rehabilitim pika kalimi etj	20	7	15
5	Ndërtim fabrike për bolitimin e ujit, vënie impiantesh dhe mendime mbi strtegjinë e ujit etj.	6	1	9
6	Njësi shërbimi (blegtorale)	0	0	18
7	Vendorsje antenash, pika transmetimi, nënstacione	9	9	22
8	Vendorsje njësi portative	0	0	56
9	Projekte gjeneruese me erë (burim energjie) etj	-	2	7
10	Agropylltari	0	0	37
11	Fabrika riciklimi, Riciklim mbetjesh spitalore etj	-	3	2
	TOTALI	147	172	320





Sipas grafikut vihet re se kërkesat e subjekteve të ndryshëm për të zhvilluar veprimtari në territorin e zonave të mbrojtura ka ardhur në rritje, kështu nga 147 raste gjatë vitit 2017, në 172 raste në vitin 2018 dhe gjatë vitit 2019, janë dhënë gjithsej 320 raste.

Sipas të dhënave në tabelë vërejmë se gjatë këtij viti janë dhënë mendime vetëm për Hec-e të ndryshëm gjithsej 92 raste. Theksojmë se për këtë grup aktiviteti (ndërim Hec-esh ka patur raste se për një Hec mund të kemi dhën mendim edhe 5 herë, kjo ka ardhur si rrjedhojë e paraqitjes së dokumentacionit të pa mjaftueshëm nga AKM apo vetë subjekti. Shpesh herë është konstatuar ridërgimi i dokumentacionit (koordinatave) për të njëjtin Hec vendodhja me koordinata të ndryshme.



Siç shihet në tabelë edhe për grupin e aktivitetit “vendosje njësi portative, shërbime për agëtime, çlodhje pushime aktivitete sportive njësi shërbimesh për vizitorët/turistët dhe komplekse turizmi etj zënë një peshë të konsiderueshme në punën tonë dhe të AdZM-ve. Janë hasur dhe aktivitete në rritje siç është rasti për zhvillime agroturistike dhe disa nga subjektet po kërkojnë që të mundësohet dhe zgjatja e afatit të kohot të kontratës. Në këtë drejtim është punuar dhe jemi në pritje të miratimit të këtij ndryshimit të afatit nga 5 vjet në 10 vjet e më shumë.

Situatë pa zgjidhje është për “Antenat”, ku kërkohet të rinfreskohen kontratt e mëparshme apo të lidhet të reja. Detyrë tjetër shumë e rëndësishme për sektorin e menaxhimit gjatë vitit 2018 ka qënë; shqyrtimi, vlerësimi dhe përgatitja e përgjigjeve për kërkesat ardhur në rrugë shkresore, dërguar nga subjekte, individë, institucione, shoqata të ndryshme etj, për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme në territorin e zonave të mbrojtura. **“Përgjigjet”** janë përgatitur bazuar në ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura” të ndryshuar dhe më pas në zbatim të ligjit nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, të akteve të tjera nënligjore si VKM-së së shpalljes të zonës së mbrojtur, zonimit të brendshëm e planit të menaxhimit, bazuar në strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura, zhvillimit për një menaxhim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe së fundmi dhe të PPV-ve të bashkive si dhe të akteve ligjore ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2019, janë përgatitur dhe kthyer përgjigje 626 shkresave të ndryshme ardhur nga subjekte, individë, institucione, shoqata të ndryshme etj dhe konkretisht jepen të grupuara si në tabelën më poshtë:

Nr	Lloj i veprimtarive	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Aktiviteti minerare (miniera kromi dhe gurore)	8	5	17
2	Ndërtim HEC-e dhe rivënie në punë të HEC-e	17	64	140
3	Ndërtime resortesh, bar-restorante, kabanone mobiljesh komplekse turizmi etj	26	15	62
4	Ndërtim segmente rrugësh, rikonstruksion, rikualifikim e rehabilitim pika kalimi etj	16	5	24
5	Ndërtim kompleksi blegtorale, për pularitë, për peshkun, projekte agropylltarie, etj	23	-	20
6	Ndërtim fabrike për bolitimin e ujit, vënie impiantesh dhe mendime mbi strategjinë e ujit etj.	4	3	18
7	Vendosje antenash, pika transmetimi, nënstacione etj	9	5	34
8	Nyje fraksionim inertesh	-	1	13
9	Propozime për shpallje ZM	-	4	35
10	Bashkëpunim ndërinstytucionale	42	345	225
11	Dhënie përgjigje në institucione të ndryshme	0	0	51
12	Të ndryshme	36	65	55
	TOTALI	181	512	626

Më poshtë japim grafikisht përqindjen që zë çdo grupim veprimtarishë, ku janë përgatitur përgjigjet shkresore për vitin 2019. Vihet re grupimi nr. 8 “Bashkëpunim ndërinstytucional” zë peshën më të madhe. Kjo tregon tendencës në rritje të lidhjes dhe komunikimin shkresor me institucione të ndryshme shtetërore si me AKPT, AZHT, ALUIZNI, MBZHR, Bashkitë, Njësitë Administrative, subjekte të ndryshëm, institucionet shkencore, akademike etj.



Duke bërë krahasimin midis tre viteve vërejmë tendencën në rritje për shkresat e ardhura. Kështu nga 181 shkresa ardhur gjatë vitit 2017, është rritur në 512 numri i shkresave të ardhura pranë sektorit në 512 gjatë vitit 2018 dhe në 626 të tilla ardhur gjatë vitit 2019. Të gjitha këto shkresa janë shqyrtuar dhe përgatitur për përgjigje në bashkëpunim me AdZM-të respektive që lidhen me kërkesën. Në kthimin e përgjigjeve të shkresave të cilat kanë lidhje për verifikime në terren bazuar në koordinatat e paraqitura për gjendjen dhe situatën kadstrale që ka sipërfaqja zonë e mbrojtur, kemi kërkuar mendimin e AdZM-ve, pasi janë ato që monitorojnë vazhdimisht territorin e zonave të mbrojtura të qarkut. Kemi patur dhe raste vonese në kthimin e përgjigjeve kjo edhe si rrjedhojë e vonesës që na ka dërguar AdZM-ja përkatëse. Kështu mund të themi për AdZM-në Shkodër, Tiranë dhe Vlorë e Durrës. Gjithashtu ka patur dhe raste ku përgjigja e dhënë nga AdZM-ja nuk

ka qënë e saktë, kjo e verifikuar këtu nga Elsoni, ndaj kërkohet më shumë kujdes dhe përkushtim nga AdZM-të që me marrjen e kërkesës të kthejnë përgjigje sa më shpejt.

Sipas grupimit të veprimtarive që janë paraqitur në tabelë dhe grafik, vërejmë se është pothuaj e njëjta tendencë. Kështu edhe për vitin 2019 për aktivitetin e Hec-ve kanë ardhur shumë shkresa si nga institucionet shtetërore (AZHT, MTM, MIE) ashtu dhe nga vetë subjektet që kanë lidhur kontratat konçesionare.

❖ Një nga drejtimet kryesore të punës me zonat e mbrojtura mjedisore është dhe zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në natyrë si atraksioni kryesor në vendin tonë. Deri më sot janë evidentuar rreth 54 pika turistike brenda territorit të zonave të mbrojtura mjedisore, por jo të gjitha të frekuentuara sa duhet. Grumbullimi dhe mbledhje e të dhënave (numrit të vizitorëve/turistëve), është realizuar duke u mbështetur në:

1. Informacionet (numri i vizitorëve/turistëve) që janë regjistruar pranë strukturave tatim– taksave të pushtetit vendor për pikat turistike që gjenden brenda sistemit të zonave të mbrojtura.
2. Informacionin i të dhënave (numri i vizitorëve/turistëve) që rezultojnë nga subjektet e resorteve dhe bujtinave ku kanë drekuar apo fjetur.
3. Të dhënat (numri i vizitorëve/turistëve), që rezultojnë sipas sontazheve të kryera nga stafet e AdZM-ve, të dhënat e skedave intervistave të realizuara në pika dhe zona të ndryshme.

Referuar të dhënave të dërguar nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në nivel qarku, për numrin e vizitorëve që kanë hyrë në territoret e ZM-ve, për periudhën Janar – Dhjetor 2019, numri i vizitorëve vendas dhe të huaj ka qënë gjithsej 4 660 987 vizitorë:

- Vizitorë vendas gjithsej 3 340 542 vizitorë
- Vizitorë të huaj gjithsej 1 320 445 vizitorë

Nga këto:


Në tabelën më poshtë, japim numrin e vizitorëve/turistëve, për çdo zonë të mbrojtur (ZM), shumën e vizitorëve për çdo kategori të zonave të mbrojtura dhe numrin totale të tyre.

Nr.	Kategoria/Emërtimi	Nr. Vizitorëve, viti 2017	Nr. Vizitorëve, viti 2018	Nr. Vizitorëve, viti 2019
I	Rezervë Natyrore Strikte			
	“Lumi i Gashit”	4750	19070	12118
	“Kardhiq “	0	0	375
1	Sub-Total	4750	19070	19070
II	Park Kombëtar			
1	“Bredhi i Drenovës”	1150	950	2250
2	“Bredhi i Hotovës”	1501	1177	1243
3	“Butrint”	167798	211495	236723
4	“Divjakë – Karavasta”	407267	364979	628232
5	“Lugina e Valbonës”	123180	116736	112132
6	“Mali i Dajtit”	107949	123475	130268
7	“Mali i Tomorrit” (Kulmak)	161876	173684	172596
8	“Prespa”	95350	106050	117060
9	“Qafshatamë”	9470	39500	79500
10	“Shebenik – Jabllanicë”	7894	26187	55003

11	“Theth”	77800	91950	98950
12	“Llogara”	64594	200910	1999014
13	“Lura”	1685	1970	8433
14	PKD “Karaburun – Sazan”	28933	67372	78560
	Sub-Total	1256447	1526435	1919964
III	Monument Natyre			
1	"Kanionet e Osumit"	1517	12478	7076
2	“Bredhi i Sotirës”	544	0	1413
3	"Kanioni i Holtës"	844	2113	3868
4	“Ujëvara e Sotirës”	1669	3469	2588
5	“Liqeni i Zi”	843	870	1372
6	“Kanionet e Sinecit”	380	0	1133
7	“Rrepet e Byshekut”	1356	2305	2120
8	“Shpella e Sarasalltikut”	34750	22400	61500
9	“Shpella e Shënanojit”	44950	45700	56461
10	“Kroi I bardhë”	150	2478	4096
11	“Liqenet e Valamarës”	78	123	182
12	“Rrapi I Bezistanit”	4567	5432	7550
13	“Dushkajat e Katerlisit”	34	79	100
14	“Pylli i Kalsë së Tunjës”	23	54	16
15	“Dushku I Leshjanit”	27	45	70
16	“Burimet e Kerpicës”	24	38	79
17	“Shkëmbi I Kabashit”	129	136	394
18	“Karst I Tervolit”	34	56	65
19	“Dushku I Bulçarit”	27	28	40
20	“Syri i Kaltër”	64495	84616	109999
21	“Ishujt e Ksamilit”	24990	11400	16769
22	“Rëra Hedhur”	0	0	30851
23	“Shpella e Haxhi Alisë”	11187	12509	12488
24	“Shpella dhe Gjiri i Gramës”	1913	2004	2145
25	“Ishulli Zvërnec”	11452	12158	12600
26	“Ujërat termale të Benjës”	26450	28800	45745
27	“Kepi i Rodonit”	7650	27500	444000
28	“Plazhi Shën Pjetër”	104060	303400	495000
29	“Selvia Fushë Krujë”	0	0	4200
30	“Shkëmbi I Kavajës”	0	0	4500
32	“Bredhi i Zhejit”	552	0	0
33	“Kanionet e Nivicës”	200	0	942
34	“Pisha e fushëkuqes” Gjinar	1808	0	76
35	“Gryka e zezë”	270	2359	3400
36	“Moçalet e Grabovës”	80	125	767
37	“Liqeni Dushkut”	95	548	737
38	“Pisha Skënderbegas”	0	0	409


39	Të tjerë	76956	0	0
	Sub-Total	276691	470551	910962
IV	Rezervat Natyror i Menaxhuar /Park Natyror			
1	“Korab – Koritnik”	19919	4167	34667
2	"Liqeni i Shkodrës"	120800	249450	126500
3	“Cangoj”	5150	3300	2750
4	“Patok-Fushë Kuqe-Ishëm”	0	0	22959
5	“Kune – Vain- Tale”	3058	44039	61258
6	“Bogovë”	0	0	1696
7	“Polis Bardhë”	0	0	843
8	“Rrushkull”	5200	5050	9500
9	“Stravaj”	0	0	88
10	“Karaburun”	22600	91034	99045
11	“Pishë Poro”	17560	138377	183700
12	“Levan”	0	0	17162
13	“Zagori”	0	0	2587
14	Sub-Total	194287	535417	678185
V	Peisazh i Mbrojtur			
1	"Lumi Buna-Velipojë"	374000	403900	480800
2	"Mali me gropa-Bizë-Martanesh"	2225	3451	28911
3	“Liqeni i Pogradecit”	444170	390278	544233
4	“Vjosë-Nartë”	0	0	77579
5	Të tjera	2063		
	Sub-Total	988506	797629	1131523
VI	Zonë e Mbrojtur Natyrore e Burimeve të Menaxhuara”			
1	“Bjeshkët e Oroshit”	0	0	1283
	Sub-Total	0	0	1283
	Total i përgjithshëm	2722744	3349102	4660987

% e numrit sipas kategorive te ZM




- Park Kombëtar
- Monument Natyre
- Rezervat Natyror i Menaxhuar /Park Natyror
- Peisazh i Mbrojtur

Krahasimi vjetor



Më poshtë kemi paraqitur grafikisht krahasimin e numrit të vizitorëve/turistëve sipas tre viteve të fundit. Sipas tabelës dhe grafikut rezulton se numri i tyre ka ardhur duke u rritur.



Paraqitja grafike e të dhënave (numri i vizitorëve/turistëve), sipas kategorive të zonave të mbrojtura (ZM), jepet në grafikun më poshtë. Shprehur në përqindje, numri i vizitorëve/turistëve që zënë ndaj numrit të tyre gjithsej për çdo kategori është:

- **Kategoria I, Rezervë Strikte Natyrore (RSN)**, numri i vizitorëve/turistëve që kanë frekuentuar zë 0.005%, ndaj numrit total të vizitorëve/turistëve për periudhën Janar – Dhjetor 2019.
- **Kategoria II, Park Kombëtar (PK)**, numri i vizitorëve/turistëve që kanë frekuentuar zë 41%.
- **Kategoria III, Monument Natyre (MN)**, numri i vizitorëve/turistëve zë 20%, ndaj numrit total.
- **Kategoria IV, Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (RNM/PN)**, numri i vizitorëve/turistëve që kanë frekuentuar gjatë kësaj periudhe, zë 15%.
- **Kategoria e V, PM (peizazh i mbrojtur)**, numri i vizitorëve/turistëve zë 24%, ndaj numrit total.
- **Kategoria e VI-të, Zona e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara** zë shumë pak rreth 0.001%.

Nëse bëjmë krahasimin e të dhënave (numrit të vizitorëve/turistëve) që kanë frekuentuar brenda kategorisë së zonave të mbrojtura (pikave turistike), vërejmë se:

Në kategorinë e II-të PK, (park kombëtar), këto zona janë frekuentuar më shumë nga të gjitha kategoritë e tjera dhe zënë 41% të numrit të vizitorëve/turistëve. Më pas vjen kategoria PM (Peizazh i mbrojtur) me 24 %, kategoria RNM/PN me 15 %, kategoria MN me 20 % dhe në fund janë kategoritë RNS dhe ZMBM me 0.01%.

Brenda kategorisë e II-të PK (park kombëtar), numri më i madh i vizitorëve/turistëve është në PK “Divjakë – Karavasta” me 628232 vizitorë/turistë, më pas PK “Butrint” me 236723, PK “Lugina e Valbonës me 112132, PK “Llogara” me 1999014, ndërsa me më pak vizitorë/turistë, është PK “Drenovë” me 2250 vizitorë/turistë.

Në kategorinë e III-të, MN (monument natyror), numri më i madh vizitorësh/turistë, është në MN “Kepi i Rodonit” me 444000 vizitorë/turistë, MN “Shpella e Sarasalltikut” me 61500, në MN “Syri i kaltër” me 109999 vizitorë/turistë e kështu me radhë dhe numrim më të vogël e ka patur MN “Dushku i Lleshanit” me 43 vizitorë/turistë.

Në kategorinë e IV-rt RNM/PN, është frekuentuar më shumë “Pishë Poro” me 183700 vizitorë/turistë , “Liqeni i Shkodrës” me 126500 dhe “Kune – Vain – Tale” me 61258 vizitorë/turistë. Gjithashtu vihet re se është frekuentuar shumë edhe PN “Korab – Koritnik” me 34667 vizitorë/turistë.


Në kategorinë e V-të PM (peizazh i mbrojtur) më shumë është frekuentuar PM “Liqeni i Pogradecit” me 544233 vizitorë/turistë dhe “Lumi Buna – Velipojë” me 480800 vizitorë/turistë.

Për vitin 2019, për periudhën Janar – Dhjetor sipas tabelës vihet re se ka rritje të numrit të vizitorëve/turistëve me gjithsej prej **1131523**. Kjo tendencë rritje vihet re dhe vihet re dhe ndërmjet viteve , kështu në vitin 2017 ky numer ka qënë me **988506** vizitorëve/turistëve.

Në tabelën më poshtë jepen të dhëna mbi numrin total të vizitorëve/turistëve sipas AdZM-ve dhe kontatojmë se AdZM-ja Fier ka numrin më të lartë me **829094** vizitorë/turistë, më pas vjen AdZM-ja Vlorë me **817659** dhe AdZM-ja Korçë me **666293** dhe më pak ka AdZM-ja Dibër me **28991** vizitorë/turistë gjithsej.

Më poshtë në grafik janë dhënë treguesit e numrit të vizitorëve/turistëve që kanë frekuentuar zonat e mbrojtura sipas qarqeve duke bërë ndërkohë dhe krahasimin midis dy viteve të fundit.

AdZM	Viti 2018	Viti 2019
Tirana	127932	148488
Vlora	737970	817659
Lezhë	100117	176908
Gjirokastër	34091	52305
Kukës	160582	149050
Korçë	502078	666293
Berat	187211	181368
Elbasan	40771	80574
Shkodër	745300	821700
Dibër	9588	28991
Fier	518419	829094
Durrës	410340	702000
Totali	3574399	4654430



- ❖ Në kuadër të krijimit të bashkive të reja dhe transferimit të fondit pyjor/kullosor me VKM nr. 433, datë 06.08.2016 u konstatua se disa parcela të ekonomi pyjore/kullosore që janë në zonë të mbrojtur i kishin kaluar bashkive respektive apo dhe raste parcelash kur nuk janë të zonës së mbrojtur sipas formularit nr. 4 po nuk janë pasqyruar dhe në listat e transferimit të bashkive të reja sipas VKM-së 433, datë 06.08.2016.

Ndodhur para gjendjes ku disa parcela pyjore (pjesë përbërëse e zonavë të mbrojtura) brenda kufinjëve natyror të tyre, ishin transferuar bashkive, u kërkua që AdZM-të të bashkëpunonin me strukturat pyjore të bashkive respective.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 1, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e kadstrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar”, sektori i menaxhimit i kërkoi çdo AdZM-je plotësimin e formularëve kadastral, me gjendjen që ka si dhe specialistët që janë ngarkuar për mbajtjen, rregullimin dhe saktësimin e sipërfaqeve kadastrale të zonave të mbrojtura duke koordinuar e krahasuar të dhënat kadastrale të formularit nr. 4 për zonat e mbrojtura me të dhënat (parcelat pyjore/kullosore), transferuar pranë bashkive të reja të bëjnë rakordimet pranë AKZM-së.

Gjatë punës u konstatua se ka raste ku parcela të ekonomive pyjore/kullosore janë të mbivendosura, apo sipërfaqja totale e zonës së mbrojtur sipas VKM-së së shpallur nuk rrezulton e tillë, pasi ka mbi vendosje të tyre punuar sipas hartave të ekonomive pyjore. Ndodhur para kësaj gjendje po punojmë duke saktësuar hartat e këtyre ekonomive me hartën e zonës së mbrojtur të miratuar. Meqenëse gjatë punës në terren u konstatuan raste ku kishte mbivendosje të sipërfaqeve të parcelave pyjore/kullosore zonë e mbrojtur me ato të transferuar bashkive, Ministria e Mjedisit dërgoj shkresën nr. 8057 prot., datë 09.12.2016 “Mbi azhurnimin e të dhënave kadastrale pyjore/kullosore dhe problematikën e transferimit”.

Gjatë punës është konstatuar se ka raste ku parcela të ekonomive pyjore/kullosore janë të mbivendosura, apo sipërfaqja totale e zonës së mbrojtur sipas VKM-së së shpallur nuk rrezulton e tillë, pasi ka mbi vendosje të tyre punuar sipas hartave të ekonomive pyjore. Ndodhur para kësaj gjendje po punojmë duke saktësuar hartat e këtyre ekonomive me hartën e zonës së mbrojtur të miratuar. Duke bërë përputhjen e tyre janë vërejtur probleme si:

Kjo ishte në përgjithësi panorama e gjendjes kadastrale për zonat e mbrojtura, problematikat lidhur me to dhe sugjerimet e dhëna për vazhdimin e këtij procesi. Duke bashkëpunuar me specialistët e GIS-it për të realizuar përputhshmërinë e treguesve kadastralë, sipërfaqet, përbërja e grumbujve pyjor, pronësia etj, është një punë që duhet të ndiqet me përparësi gjatë këtij viti ku përkon dhe me procesin e Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve në Shqipëri.

Një ndër detyrat kryesore për vitin 2017 ka qënë dhe saktësimi e standartizimi i sipërfaqeve kadastrale për zonat e mbrojtura, ndryshimet e bëra, plotësimi i formularëve për ndryshimet kadastrale, në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 03.04.2013 “Për rregullat dhe mënyrën e mbajtjes, skedimit, funksionimit dhe përdorimit të rregjistrimit të zonave të mbrojtura” (apo duke i'u referuar dhe ndryshimeve që mund të bëhen).

Në kuadër të bashkëpunimit dhe koordinimit të problematikave me pushtetin vendor, me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm, sektori i menaxhimit nëpërmjet specialistit të GIS-it këtu, përgatiti dhe u dërgoi të gjitha bashkive të vendit resurset natyrore (zonat e mbrojtura (apo pjesë të tyre) dhe monumentet e natyrës) që gjenden brenda territorit të tyre. Këto të dhëna i'u dërguan të gjitha bashkive me shkresa zyrtare duke u kërkuar dhe konfirmim.

- ❖ Detyrë e rëndësishme për vitin 2019 ka qënë dhe propozimi e rishikimi tërësor i zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës (MN) lidhur me ndryshimin e statusit, sipërfaqeve, zonimit të brendshëm, meqenëse jemi në kuadër të përgatitjes dhe shpalljes së akteve nënligjore të Ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Me ndihmën e specialistit të GIS-it është punuar dhe përgatitur harta me kufinj të fizik dhe koordinata të gjeoreferuara për çdo zonë të mbrojtur, ndryshimet që propozohen të bëhen dhe koordinimi i punës me AdZM-të. Po kështu është punuar dhe për monumentet e natyrës (MN). Lidhur me MN-të, gjatë vitit 2019 u shpall VKM-ja nr.303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”. Siç dihet gjatë vitit 2018 u punua shumë në bashkëpunim me AdZM-të për verifikimin e gjendjes për të gjithë MN-të që ishin shpallur me VKM-në e parë nr.676, datë 20.12.2002. Sipas AdZM-ve gjatë verifikimeve në terren rezultonte se një pjesë e këtyre monumenteve kishin humbur vlerat e tyre, ndaj dhe u propozuar që të hiqeshin nga lista dhe ndërkohe u propozuan në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe ekspertë mjedisor disa nga MN-të për të hyrë në listën e re për miratim dhe shpallje të statusit. Gjatë punës tonë të përditshme janë vërtetuar edhe disa mangësi si; jo të gjithë AdZM-të kanë bërë verifikim të kujdesshëm për gjendjen natyrore dhe biologjike të MN-ve, pasi ka ndodhur se disa MN (biomonumente) me pemë të llojit Rrap, janë tharë dhe nga këto AdZM po kërkojnë tu hiqet statusi si zonë e mbrojtur. Në zbatim të ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 17 për MN-të, të kuptohet qartë nga AdZM-të dhe të ndjekë duke monitoruar vazhdimisht gjendjen e tyre. Për këtë lloji kërkuar që të gjithë AdZM-të Brenda muajit Shkurt 2020 të verifikojnë në terren realisht gjendjen e MN-ve dhe ti dërgojnë pranë AKZM-së. Duhet që çdo MN të identifikohet sipas Skedës Biologjike që kanë ato me koordinata në vend.

Një detyrë tjetër është dhe pjesëmarrja në dëgjesat publike pranë AKPT-së në kuadër të hartimit të planeve të përgjithshme vendore (PPV) dhe VSM-ve të bashkive. Në të gjitha këto takime kemi qënë pjesëmarrës, kemi diskutuar lidhur me përputhshmërinë e ligjit të nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” me perspektivën që do të kenë planet zhvillimore të bashkive të reja hartuar nga studiot konsulente.

Në këto takime kemi kërkuar që në këto plane zhvillimore të bashkive të merren në konsideratë:

Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

VKM-të përkatëse për shpalljen e zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës.

Kategoritë e zonave të mbrojtura (statusin e mbrojtjes).

Zonimi i brendshëm i zonës së mbrojtur.

Veprimtaritë e ndaluara dhe ato të lejuara brenda zonës së mbrojtur.

Statusin e veçantë për monumentet e natyrës (MN) veçanërisht për shpellat, kanionet e hidromonumentet. Gjatë diskutimeve kemi shprehur sugjerime dhe për zonat e mbrojtura, propozuar për tu shpallur të tilla.

Gjatë zhvillimit të këtij procesi kanë qënë prezent dhe përfaqësues të AdZM-ve ku kanë dhënë sugjerimet e tyre, duke diskutuar për raste konkrete ku mund të zhvillohen veprimtari e aktivitete të lejuara në këto zona.

Nga ana e saj AKPT si organizatore dhe drejtuese e këtij procesi ka qënë mbështetëse për ruajtjen dhe zhvillimin e natyrës dhe biodiversitetit në mjedis dhe veçanërisht për zonat e mbrojtura.

Theksojmë se në përgjithësi studiot konsulente për hartimin e këtyre planeve i kanë marrë në konsideratë sugjerimet, vërejtjet dhe mendimet tona dhe i kanë materializuar në këto plane.

- ❖ Detyrë tjetër që u ndoq me vëmendje nga sektori i menaxhimit ishte dhe kërkesa e bërë nga disa AdZM për gjetjen e një zgjidhje ligjore “Furnizimi me dru zjarri i banorëve me banim të përhershëm që ndodhen brenda zonave të mbrojtura”.

Dihet që misioni dhe detyra kryesore e AKZM-së është ruajtja e natyrës dhe biodiversitetit në territorin e zonave të mbrojtura, por krahas konservimit, si domosdoshmëri të synohet dhe drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të këtyre zonave. Meqenëse për disa zona të mbrojtura janë hartuar dhe planet e

menaxhimit, ku përcaktohen qart dhe saktë prioritetet që ka çdo nënzonë (sipas zonimit të brendshëm), bëhet e mundur dhe mundësia për kryerje të disa veprimtarive që nuk çojnë në përkeqësim të vlerave të natyrës e mjedisit. Gjithashtu banorët e komuniteteve që ndodhen brenda territorit të zonave të mbrojtura janë dhe konsiderohen si partner të AdZM-ve. Për shkak të Moratoriumit të Pyjeve dhe nevojës së popullatës vendase (brenda zonave të mbrojtura) për dru zjarri nga ana e AdZM-ve janë bërë kërkesa të vazhdueshme për tu furnizuar me dru zjarri. Në zbatim të ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 46 “Pyjet, kullotat, ujërat dhe pasuritë e tjera natyrore brenda zonave të mbrojtura”, pikat 1, 2, 3, dhe 4 u përgatit Urdhëri nr. 198, datë 31.08.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm për të mundësuar furnizimin me dru zjarri familjet me banim të përhershëm brenda territorit të zonave të mbrojtura.

Në zbatim të këtij Urdhëri, u është kërkuar AdZM-ve që të zbatojnë me përpikmëri të gjitha kushtet dhe kriteret që burojnë nga ky urdhër.

AdZM-të që paraqitën projektet për rehabilitim të zonës pyjore (propozuar prej tyre) u shqyrtuan dhe u bë vlerësimi i tyre bazuar në kriteret teknike e silvobiologjike të sipërfaqeve pyjore.

Gjatë viti 2019 dërguan projekte “Për rehabilitimin dhe shëndetësimin e sipërfaqeve pyjore për prodhim dru zjarri”, planifikuar për furnizimin e banorëve me banim të përhershëm në zonat e mbrojtura, për shqyrtim dhe miratim AdZM-të, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, Fier, Berat dhe Tiranë.

Pas miratimit të këtyre projekteve, sektori i menaxhimit përgatiti MEMO-n dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm për zbatim dhe ndërkohë u kërkoi AdZM-ve që në përfundim të procesit të paraqitnin një raport të hollësishëm mbi zbatimin e këtij urdhëri për punën e bërë sipas fazave të parashikuara në projekt. Por ndërkohë sektori nuk ka miratuar projektet e paraqitur nga AdZM Berat dhe Tiranë, pasi këto projekte janë dërguar me shumë vonesë, jashtë afatit.

AdZM-të duhet që këto studime dhe projekte duhet ti dërgojnë për miratim brenda afatit (fundi i muajit Mars) dhe kur zonat pyjore që do të planifikohen për ndërhyrje shëndetësimi, janë me dëborë ky afat shkon deri me 30 Prill.

Nga verifikimet e kryera në terren dhe materiali shkresor rrezulton që kushtet dhe kriteret e kushtëzuara në këtë urdhër janë respektuar, marrë e vlerësuar me korrektësi nga AdZM-të.

❖ **Në fushën e faunës së egër**

Sektori i menaxhimit u ka shpërndarë AdZM-ve Manualin e metodikave të inventarizimit dhe monitorimit të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie dhe Urdhërin e Ministrisë nr. 01., datë 11.02.2016. Gjithashtu u janë shpërndarë udhëzimi dhe protokollet e terrenit për inventarizimin e faunës së egër. Në kuadër të “Inventarit për sistemin e monitorimit të faunës së egër” nëpërmjet INCA-s, nga sektori i menaxhimit është ngarkuar një specialist z. Fatmir Kryeziu i cili është personi i kontaktit dhe ka ndjekur në vazhdimësi gjithë procesin e inventarizimit të faunës së egër, duke mbajtur dhe të dhënat përkatëse. Në këtë kuadër janë zhvilluar disa trajnime me përfaqësues të të gjitha AdZM-ve, veçanërisht për inventarin e shpendëve ujorë. Ky proces po vazhdon edhe gjatë vitit 2019.

TË DHËNAT E INVENTARIZIMIT TË FAUNËS SË EGËR NË ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), është institucionalizuar me VKM nr.102, datë 04.02.2015, si strukturë funksionale e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit.

Kjo Agjenci që nga 6-mujori i dytë i vitit 2017 e në vazhdim është përfshirë në kryerjen e punës, për ndjekjen permanente, të Vëzhgim-Monitorimit të Faunës së Egër, në teritoret e sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, sipas specieve të përcaktuara për këtë qëllim. Në Vëzhgim-Monitorim, janë gjithsej 40 specie,

Nga këto specie, 13 janë kafshë dhe 27 prej tyre janë shpendë. Speciet e kafshëve grupohen në gjitarë të mëdhenj, të mesëm dhe gjitarë të vegjël, sikundër shpendët grupohen në ujorë e jo ujorë.

Nga këto 40 specie, 17 prej tyre janë shpallur objekt gjuetie, kurse 23 të tjerat, konsiderohen specie kryesore të faunës së egër, ndaj janë përcaktuar për vëzhgim dhe monitorim.

Procesi, realizohet nëpërmjet punës së përditëshme të Rangers-ave (Rojeve Mjedisore), sipas AdZM-ve në të 12-të qarqet e vendit.

Bazuar në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 92/43/EEC e datës 21 maj 1992, mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës e florës së egër (Direktiva e Habitaveve), dhe gjithashtu në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 79/409/EEC e datës 2 prill 1979 mbi ruajtjen e shpendëve të egër (Direktiva e Shpendëve), AKZM ka krijuar një Sistem të Monitorimit të Faunës së Egër “AKZM-SiMF”, si sistem kombëtar i monitorimit, i njëjësuar me sistemin e BIONNA-s, si sistem ndërkombëtar i monitorimit. Vazhdon të praktikohet hedhja online e të dhënave nëpërmjet aplikimit të këtij sistemi të ri, në mënyrë të përditësuar.

Evidentimi i specieve dhe identifikimi i tyre realizohet sipas këtyre *mënyrave*; Kamera Kurth, Vrojtje direkt, Jashtëqitje, Gjurmë, Tjetër (Pupla, Qime etj). Përveç këtyre, në tërësinë e të dhënave të Rangers-ave, në bashkëpunim me specialistët e AdZM-së përkatëse, janë plotësuar edhe informacioni për datën, orën, koordinatat në gradë Decimal, pra jo në UTM dhe vendin e identifikimit (zonë e mbrojtur apo jo dhe emri popullor), konfliktet e ndodhura, lloji i dëmit të shkaktuar dhe koha e kryerjes së tij, ngordhjet e konstatuara në F. Egër (koha, shkaku, mënyra e ngordhjes dhe gjinia e moshës për specien e ngordhur), pa përjashtuar këtu shënime apo sqarime të tjera specifike për çdo rast, sipas zonave të mbrojtura ku është kryer Vëzhgim-Monitorimi.

Më poshtë po japim të dhënat vjetore sipas specieve dhe mënyrave të identifikimit, duke nënvizuar faktin që këto tregues të interpretohen si rekorde/raste dhe jo si numër fizik.

Po në këtë kuadër lidhur me faunën jemi bërë pjesë e takimeve dhe për “Problemet e shpëtimit të kafshëve të egra në gjendje kaptiviteti”. Kemi qënë pjesëmarrës në disa takime, organizuar nga “INCA”, lidhur me mbrojtjen e disa arinjve nga kushtet e robërisë që ishin nëpër zona të ndryshme të vendit. Është ndjekur nga afër dhe kryerja e trajnimeve të Rangers-ave të cilët tashmë e kanë detyrë funksionale dhe inventarizimi i Jetës së Egër me objektiv – “Sigurimi i informacionit të duhur, përmes monitorimit, lidhur me tendencat në popullatën në faunën e egër, si dhe mbi trusninë e kërkëcënimeve, në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i ruajtjes dhe vendimarrja ndaj saj”. Njëherazi po krijohet një Sistem i Monitorimit të Faunës së Egër (SiMF), nëpërmjet instalimit të Kamerave Kurth. Ky sistem monitorimi do të jetë i ndërthurur edhe me atë të BIONNA-s (Sistemi Ndërkombëtar i Monitorimit).

Për të realizuar këtë objektiv u përgatitën 5 protokolle (formularë) dhe më pas u përmbledhën në një të vetëm, kjo për të krijuar lehtësi në plotësimin e tyre nga Rangers-ave. Ky formularë përmbledhës, përmban speciet objekt inventarizimi dhe mënyrat e identifikimit të tyre në terren. Gjithsej këto specie janë 30 (tridhjetë) dhe mënyrat për identifikimin e tyre janë të ndryshme. Gjatë vitit 2017 është ndjekur në veçanti edhe Censusi (Inventarizimi) i shpendëve ujor/dimëronjës, për të cilat janë mbledhur dhe të dhënat. Detyrë që është ndjekur por që duhet të vazhdojë gjatë këtij viti është përfundimi i Skedave biologjike për zonat e mbrojtura.

Gjatë vitit 2019 sektori i menaxhimit ka ndjekur dhe çështje të tjera si:

- Inventarin Kombëtar të Pyjeve
- Pyllëzime me fidanë pyjor e frutor brenda dhe jashtë ZM-ve (Mbjelle pemësh)

Problematika në AdZM-të

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2017 lidhur me punën e AdZM-ve ka vërejtur se krahas plotësimit të detyrave kanë patur dhe mangësi si:

Pothuaj të gjitha AdZM-të kanë vonesë në plotësimin e formularëve të ndryshimeve kadastrale, po kështu dhe puna që duhej realizuar në bashkëpunim me bashkitë respective për rastet ku ka mbivendosje të sipërfaqeve të parcelave.

AdZM-ja Berat

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në përshkrimin e informacionit.
- Ka patur vonesa në kohë për dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.

AdZM-ja Fier

- Ka patur vonesa në kohë për dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.
- Sektori menaxhimit nuk u përgjigjet në kohëkërkesave për dhënie mendimi.
- Ka paqartësi në ndjekjen e detyrave që u lihen për zbatim.

AdZM-ja Durrës

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në përmbajtjen e raporteve, informacioneve.
- Nuk është përgjigjur në kohën e duhur kërkesave të bëra nga sektori i menaxhimit veçanërisht lidhur me dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.

AdZM-ja Lezhë

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.
- Nuk është përgjigjur në kohën e duhur kërkesave të bëra nga sektori i menaxhimit veçanërisht lidhur me dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.

AdZM-ja Korçë

Krahas punës së mirë janë vrejtur mangësi si:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.

AdZM-ja Tiranë

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në informacione të cilët janë të vakta dhe me përmbajtje jo të rregullt.
- Nuk ka ndjekur në vijimësi problematikat që kanë rezultuar nga subjektet që kryejnë veprimtari të paligjshme në zonat e mbrojtura (Guroret).

AdZM-ja Dibër

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.
- Nuk ka ndjekur në vijimësi problematikat që kanë rezultuar nga subjektet që kryejnë veprimtari në zonat e mbrojtura (HEC-et dhe minierat).

AdZM-ja Elbasan

- Nuk u është përgjigjur në kohë shkresave të skanuara apo kërkesave për dhënie mendimi.
- Nuk ka ndjekur në vijimësi problematikat që kanë rezultuar nga subjektet që kryejnë veprimtari të paligjshme në zonat e mbrojtura (HEC-et dhe minierat).

AdZM-ja Kukës

- Nuk ka ndjekur sa duhet problematikat që kanë rezultuar me subjektet që kryejnë veprimtari në zonat e mbrojtura (HEC-et dhe minierat).
- Nuk ka dërguar në afat evidencat mujore.

AdZM-ja Gjirokastrë

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në informacione.
- Nuk ka dërguar në kohë dhënien e mendimeve me shkresat e skanuara.

AdZM-ja Vlorë

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave.
- Nuk ka dërguar në kohë studimet që duhet të realizohen veçanërisht për rastet kur ka rrëzim të pemëve në zonat e mbrojtura, Nuk dërgoi brenda vitit evidencën e kontratave të lidhur në sipërfaqet kullosore (rasti i pemëve të rrezuar nga tornado në PM Vjosë – Nartë).

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2019, ka kryer e realizuar detyrat e ngarkuara dhe në saj të një bashkëpunimi me sektorin e monitorimit, të projekteve si dhe me Drejtorinë e Financës dhe shërbimeve të brendshme. Po kështu ka bashkëpunuar dhe me institucione të ndryshme shtetore si:

- Me Drejtorinë e Zonave të Mbrojtura dhe Biodiversitetit ku një ndër detyrat e realizuara ka qënë dhe Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në zonat e mbrojtura, për materialin final lidhur me zonën pyjore të Rajcës shpallur Pasuri e Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe Kulturore po kështu dhe për pjesën shqiptare të zonës së liqenit të Ohrit.
- Drejtorinë e Trajtimit të Pyjeve dhe Kullotave në MM, lidhur me problemet kadastrale, veçanërisht me HEC-et.

- AKM-në, lidhur me dhëniet e mendimeve për veprimtaritë e lejuara dhe të kërkuara në zonat e mbrojtura.
- MBZHURU-në për Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, ku kemi qënë pjesëmarrës në të gjitha takimet e organizuara, kërkuar dhe arritëm që AKZM-ja të jetë pjesë e kësaj strategjie.
- ALUIZNI-n (kemi dhënë informacion lidhur me ndërtimet që ndodhen në zonat e mbrojtura, duke përcaktuar qartë zonën e mbrojtur, kategorinë e saj, zonimin e brendshëm dhe bazuar në planin e menaxhimit mbi lejueshmërinë e veprimtarive në këto zona),
- AZHT dhe AKPT për PPV dhe VSM-të e bashkive dhe problem të tjera lidhur me territorin.
- AKB dhe Ministrinë e Kulturës (IMK dhe ASHA) lidhur me PK “Butrint” dhe vijën bregdetare.

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2019 gjithashtu ka ndjekur

- ❖ Punën për përgatitjen e kthimin e përgjigje të shkresave ardhur në adresë të AKZM-së.
- ❖ Specialistët e sektorit janë aktivizuar në punë të përbashkëta dhe me sektorin e monitorimit (gjatë kontrolleve të ushtruara në AdZM-të e qarqeve). Në bashkëpunim me këtë sektor pothuaj në të gjitha kontrollet e kryera krahas monitorimit është bërë dhe kontrolli i zbatimit të urdhërave të dala lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.
- ❖ Sektori i menaxhimit ka ndërtuar një databasë kombëtare për vendodhjen e të gjithë HEC-eve dhe aktiviteteve të tjera industriale dhe ekonomike.
- ❖ Në bashkëpunim me AdZM-të e qarqeve u mbodh dhe u grumbullua dokumentacioni teknik që disponojnë subjektet në terren, nga ku u bë dhe klasifikimi i tyre se në çfazë janë ato (ndërtimi apo proces prodhimi). Jemi në përditësimin e këtij databezi, pasi në terren jepen informacione të reja nga AdZM-të. Kjo detyra do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2018, për të saktësuar vendodhjen e tyre sipas koordinatave.

IV . Objektivat për vitin 2020

- Detyrat kryesore të Sektorit të Menaxhimit për vitin 2020, dalin nga programi “Mbi Strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura” dhe konkretisht do të jenë:
- Puna e sektorit të menaxhimit gjatë këtij viti do të mbështetet në tre shtylla kryesore:
- a. Punë e thelluar dhe argumentuar (për çdo përgjigje apo dhënie mendimi të shprehemi me përmbajtje të thelluar, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi).
- b. Shpejtësi në kryerjen e veprime.
- c. Saktësi në vendime.
- 1. Organizimi i punës për hartimin, standartizimin dhe mbajtjen e të gjithë të dhënave nëpërmjet përdorimit të teknologjive të avancuara. (Rregjistri Kombëtar), për të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë që do të kryhen dhe trajtohen gjatë vitit 2020.
- 2. Monitorimi i vazhdueshëm i florës dhe faunës së egër në zonat e mbrojtura, krijimi dhe mbajtja e databasës së të dhënave të marra.
- 3. Vazhdimi i punës për saktësimin dhe standartizimin e treguesve kadastral për zonat e mbrojtura në bashpunim me Drejtorinë përkatëse në Ministri (zona e mbrojtur, ekonomia pyjore/kullosore, parcelat e tyre, sipërfaqet, hartat përkatëse).
- 4. Verifikimi mbi kontratat ekzistuese të lidhura nga ish-DRSHP-të, ndjekja e tyre mbi zbatimin e menaxhimin e veprimtarive të lejuara në përshtatje të ligjit të zonave të mbrojtura deri në likuidimet financiare totale. (Kjo detyrë do të kryhet në bashkëpunim me AdZM-të dhe Drejtorinë e Finacës).
- 5. Hartimi i Draft- Kontratave për veprimtari të lejuara në zonat e mbrojtura duke synuar në vjeljen e grumbullimin e prodhimeve të dyta pyjore brenda zonave të mbrojtura.

- 6. Meqenëse tashmë stafet e AdZM-ve janë trajnuar të fillojnë puna për hartimin e planeve të mbarështrimit të pyjeve nga specialistët e AdZM-ve, ndjekja e realizimit të tyre dhe përmirësimi i metodologjisë.
- 7. Hartimin dhe zhvillimin e studimeve për mbarështrimin e kullotave (për kapacitetin mbajtës, gjendjen floristike dhe elementeve të infrastrukturës e kuztuese, rekomandime për përmirësimin e tyre) nga specialistë të AdZM-ve, ndjekja e realizimit të tyre.
- 8. Hartimi i planeve dhe gjetja e metodave për mirëmenaxhimin e zonave turistike, ngritja e grupeve të punës për informimin dhe shoqërimin e turistëve që frekuentojnë këto zona.
- 9. Studimi dhe përmirësimi i disa planeve të menaxhimit, bazuar në objektivat e reja për zonat e mbrojtura dhënë nga Strategjia Kombëtare dhe PPV-të e bashkive të miratuara.
- 10. Hartimi i planeve për ndërhyrjet e nevojshme me përmirësim të infrastrukturës në zonat e mbrojtura, për furnizimin me dru zjarri të familjeve me banim në zonat e mbrojtura.
- 11. Organizimi i punës për gjetjen e burimeve të të ardhurave në zonat e mbrojtura për çdo AdZM, si kontrata për kullotat, bimët mjeksore, prodhime të dyta pyjore e jo pyjore, dhënie në përdorim të sipërfaqeve për ushtrim aktivitetesh etj, (sipas specifikave që ka çdo zonë e mbrojtur).

Spektori i Projekteve